



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike
Mbledhja nr. 13
Prishtinë, më 01 qershor 2010, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJE TË FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Haki Shatri, Safete Hadergjonaj, Kosara Nikoliq, Gani Koci, Synavere Rysha, Naser Osmani dhe Enis Kervan.

Munguan: Riza Smaka dhe Anita Morina – Saraçi.

Të ftuar për të marrë pjesë: nga RTK-ja, Rrahman Paçarizi, kryetar i bordit të RTK-së (mungoi), nga MEF-i, NJQH, zv.ministri - Bedri Hamza dhe drejtori i NJQH-së, Kosum Aliu.

Të pranishëm: Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit, Fatime Qorri, zyrtare ligjore, nga KIPRED (staf mbështetës) Artan Venhari dhe Albert Krasniqi, Ilire Daija – Buza dhe Qëndresa Mulaj - ZAP.

Mbledhjen e kryesoi Haki Shatri, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 05. 05. 2010,
3. Shqyrtimi i Raportit për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2009,
4. Shqyrtimi i pasqyrave financiare dhe i raportit të auditorëve të pavarur të RTK-së, për vitin 2009,
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi – I njoftoi anëtarët e Komisionit se procesverbali i mbledhjes së kaluar është në procedurë të përkthimit.

Synavere Rysha – Propozoi që pika e katërt e rendit të ditës të hiqej nga rendi i ditës, pasi që KMFP-ja e ka kërkuar raportin e audituar të RTK-së, ndërsa raporti i propozuar në rend dite, realisht është raport vjetor i Bordit të RTK-së, i cili nuk ka asnjë nënshkrim. Ne duhet ta kërkojmë raportin e audituar të RTK-së, ose duhet ta riformulojmë këtë pikë të rendit të ditës.

Gani Koci – Sipas rekomandimit të KBF-së, Kuvendi e ka kërkuar raportin e audituar të RTK-së, nga ZAP-i. Raporti që e ka proceduar RTK-ja është vetëm përsëritje e raporteve të viteve të mëparshme. Ne si Komision duhet ta diskutojmë këtë raport, por duhet të dalim me rekomandimin që ky raport nuk pranohet, sepse kërkohet raporti i audituar nga ZAP-i.

Kryesuesi – I njoftoi anëtarët e Komisionit se për këtë mbledhje ishte ftuar kryetari i Bordit të RTK-së dhe kishin marrë përgjigje se kishin një takim tjetër. Si pasojë e kësaj nuk kishin mundësi të merrnin pjesë në këtë mbledhje. Raporti i ishte dorëzuar Kuvendit si raport i audituar, jo si raport i RTK-së.

Kosara Nikoliq – Propozoi që kjo pikë të hiqej nga rendi i ditës, sepse ka vërejtje se raporti i paraparë për shqyrtim nuk është raport i audituar i RTK-së, por raport vjetor i RTK-së. Komisioni të kërkojë që kryetari i Bordit të RTK-së të marrë pjesë në mbledhje që ta ndihmojë shqyrtimin e kësaj pike.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 05. 05. 2010

Kosara Nikoliq – Pati vërejtje se në versionin serbisht, në pjesën “*morën pjesë*”, nuk figuron emri i saj.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi procesverbalin e datës 05 maj 2010, me vërejtje në versionin serbisht, të deputetes Kosara Nikoliq.

2. Shqyrtimi i Raportit për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2009

Kryesuesi – Tha se sipas Ligjit për auditimin e brendshëm, NJQH-ja i raporton Kuvendit, ndërsa sipas planit të punës, KMFP-ja e shqyrton këtë raport dhe e procedon në seancë plenare. E ftoi zv.ministrin e MEF-it ta paraqiste raportin.

Bedri Hamza, zv.ministër i MEF-it – E paraqiti raportin për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2009. Tha se aktivitetet janë përqendruar në përmbushjen e planit vjetor, kryesisht në infrastrukturën ligjore dhe në ngritjen e kapaciteteve të auditimit të brendshëm, në harmonizimin e infrastrukturës ligjore me standardet dhe me praktikat ndërkombëtare, në harmonizimin e UA-së, në ngritjen profesionale të auditorëve të brendshëm, në bashkëpunimin e njësisë me ZAP-in, në promovimin e auditorëve të brendshëm, si dhe në publikimin dhe në shpërndarjen e doracakut të auditimit të brendshëm te auditorët e brendshëm. Janë nxjerrë dy udhëzime administrative: UA për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës së pajisjes me licencë të përkohshme të auditorëve të brendshëm në sektorin publik dhe UA për themelimin dhe për funksionimin e njësisë së auditimit të brendshëm të sektorit publik. NJQH-ja ka organizuar trajnime me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale. Gjatë vitit 2009 janë kryer 360 auditime në nivelin qendror dhe në atë lokal, 2207 rekomandime për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, janë zbatuar 1215 ose 55%, në proces të zbatimit janë 524 ose 23.74%, nuk janë zbatuar 468 ose 21.21%. Rekomandimet që nuk janë zbatuar janë dhënë në tremujorin e katërt dhe përcjellja e zbatimit të tyre është planifikuar të bëhet gjatë vitit 2010.

Naser Osmani – Ligji aktual a ka zbrazësi? A ka nevojë të ndryshohet që auditorët e brendshëm ta kryejnë punën më me autoritet dhe në mënyrë më të pavarur? Kapacitetet për auditim të brendshëm në bazë të numrit të organizatave buxhetore kanë mangësi. Cila është kërkesa e NJQH-së, që Parlamenti të ndikojë që këto kapacitete të rriten në aspektin sasior apo cilësor? Komitetet e auditimit është e nevojshme të rriten në mënyrë që të kryhen punët. Si mund të ndihmojë Komisioni që kjo njësi ta ngrejë nivelin profesional?

Synavere Rysa – E përkrahu raportin e NJQH-së. Tha se raporti në përgjithësi është i shkurtër, i përmbledhur dhe përmbajtjesor. NJQH-ja është një institucion që punon shumë, dhe i vetmi mekanizëm që e ka për qëllim rritjen e performancës në institucione. Duhet të sensibilizohet vetëdija e menaxherëve se auditori ia do të mirën punës së organizatës ku punon.

Enis Kervan – Tha se raporti i paraqet zhvillimet në fushën e auditimit të brendshëm në nivel qendror dhe në nivel lokal. Deri ku është arritur me komunat e reja të cilat janë krijuar dhe ende nuk janë krijuar njësitë e auditimit?

Gani Koci – Pyeti se cili është raporti ndërmjet auditorëve, komiteteve dhe NJQH-së, sepse në shumë organizata buxhetore nuk funksionojnë sa duhet këto bashkëpunime. Me ligjin e kaluar kemi pasur problem për sa i përket kompensimit të auditorëve dhe ka pasur disharmoni nëpër njësi. A është evituar ajo disharmoni dhe a është harmonizuar për sa i përket auditorëve të brendshëm mbi bazë të Ligjit të ri të auditimit të brendshëm? Raportet e ZAP-it bëhen në bazë të raporteve të auditorëve të brendshëm të organizatave buxhetore. Ndoshta duhet t'i analizojmë edhe këto raporte, nëse ZAP-i i merr si të gatshme ose i shqyrton sipas ligjit mostrat për çështje të caktuara dhe mbi këtë bazë i përpilon raportet. Nuk dëshirojmë që për ZAP-in të punojnë auditorët e njësive të auditimit që janë nëpër organizata buxhetore.

Kryesuesi – Raporti i ka të gjitha elementet që duhet të shërbejnë si bazë për diskutim dhe ne e mbështesim atë. Duke u nisur nga fakti se organizatat buxhetore janë të detyruara, sipas ligjit, që ta formojnë njësinë e auditimit të brendshëm, ndërsa mundësitë buxhetore për staf i kanë të kufizuara, pyeti: A mund të ndodhë që në këtë rast të merren njerëzit që janë më pak të dobishëm? NJQH-ja duhet të bëjë presion që në organizatat buxhetore të shkojnë njerëz me kualifikime të duhura profesionale. Vendosija e raporteve të mira me ZAP-in është bazë e mirë për funksionimin e NJQH-së. Rekomandimet e raportit duhet të përmbushen dhe kjo bie mbi barrën e MEF-it. E ftoj drejtorin e NJQH që të përgjigjet në pyetjet e deputetëve.

Kosum Aliu - drejtor i NJQH-së, MEF - Ligji aktual është i mirë dhe i harmonizuar me kërkesat e Komisionit Evropian. Shqetësues është fakti se në disa organizata buxhetore njësi është me një auditor. Disa organizata të vogla buxhetore nuk kanë arritur të krijojnë njësi të auditimit të brendshëm. Kosova e mbulon fushën e auditimit me 88%. NJQH-ja për krijim e njësive të brendshme ka nxjerrë udhëzim administrativ, me të cilin janë përcaktuar kriteret për këto njësi. Përgjegjësia për themelimin e njësive i përket menaxhementit si: ministrit, kryetarit të komunës, kryeshefit të agjencisë etj. Komiteti i Auditimit është organ në mes të menaxhmentit dhe auditimit, në njërën anë mbron auditorin prej menaxhmentit, por edhe në anën tjetër e udhëheq menaxhmentin që t'i çojë përpara të gjeturat e auditorit, pra ta hartojë një plan të veprimit për t'i zbatuar rekomandimet e auditorit. Sa u përket pagave të auditorëve, në Ligjin për paga duhet të merret parasysh kjo. Auditorët janë të pavarur, por *“ne e dimë sa jemi të pavarur”*, duke u bazuar në atë se auditori duhet të jetë i kujdesshëm çka shkruan. ZAP-i e shfrytëzon raportin e brendshëm, pastaj vazhdon më tutje që të mos dyfishohet puna e auditorëve të mirë.

Kryesuesi – Propozoi të nxirret një rekomandim për ta kërkuar pavarësinë e auditorëve.

Gani Koci – Tha se pavarësinë auditorëve e siguron ligji. NJQH-ja duhet të insistojë që auditorët e brendshëm, në kuptimin e autorizimeve që kanë, të jenë të pavarur.

Safete Hadergjonaj – Ky raport ka përmirësime me miratimin e ligjit të ri për auditimin. Përparësia qëndron në atë se së pari është bërë monitorimi i ligjit, pastaj është hartuar ligji i ri. Në ligj është përcaktuar pavarësia e auditorëve. Prandaj nuk u pajtua me propozimin për një rekomandim për pavarësinë e auditorëve.

Kryesuesi – Tha se duhet gjetur zgjidhje të tjera lidhur me këtë çështje, në mënyrë që auditori të jetë i pavarur në punën e tij. Auditori nuk mund të jetë i pavarur, pavarësisht pse quhet i tillë, përderisa propozohet dhe emërohet nga eprori i tij.

Kryesuesi konstatoi se KMFP-ja njëzëri vendosi që Kuvendit t'i

REKOMANDOJË

1. Të miratohet raporti për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2009.
2. Të insistohet në përmbushjen e kushteve për funksionalizimin sa më të plotë të auditorit të brendshëm, në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, nëpër organizata buxhetore.

3. Shqyrtimi i pasqyrave financiare dhe i raportit të auditorëve të pavarur të RTK-së, për vitin 2009

Kryesuesi – Ne nuk mund ta diskutojmë një raport të tillë pa praninë e përfaqësuesve të këtij institucioni. Propozoi që Komisioni ta njoftojë Kryesinë e Kuvendit për arsyet e mosshqyrtimit të këtij raporti.

Synavere Rysha – Tha se tani përgjegjësia duhet të kërkohet te auditori, jo te RTK-ja. Përderisa në raport ka shënime për auditorin, atëherë auditori duhet ta marrë përgjegjësinë për këtë. Ky raport është pa nënshkrim dhe si i tillë nuk duhet të pranohet.

Gani Koci – I pranishëm në mbledhje do të duhej të ishte edhe ZAP-i, nëse raporti është proceduar nga ky institucion. Përgjigjja e përfaqësuesve të RTK-së për mospjesëmarrje në mbledhje të Komisionit është e njëjtë si të gjitha përgjigjet që i kemi marrë edhe në KBF. Ky raport nuk mund të shqyrtohet sot, sepse duhet të jenë të pranishëm ZAP-i dhe kryetari i Bordit të RTK-së. Detyrimi për ta proceduar në Kuvend raportin e audituar të RTK-së nga ZAP-i, deri më 15 mars të këtij viti, nuk është kryer.

Kryesuesi – I njoftoi anëtarët e Komisioni se KMFP-ja e ka kërkuar nga ZAP-i raportin e auditorëve të pavarur. ZAP-i e ka dorëzuar këtë raport, që është temë diskutimi - versionin në gjuhën angleze dhe ka njoftuar se i është dorëzuar kryetarit të Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se KMFP-ja njëzëri e nxori këtë

Përfundim

- *Shqyrtimi i pasqyrave financiare dhe i raportit të auditorëve të pavarur të RTK-së, për vitin 2009, shtyhet për mbledhjen e radhës të Komisionit, për arsye të mospjesëmarrjes së kryetarit të Bordit të RTK-së në mbledhje, edhe pse ishte i ftuar.*
- *Lidhur me këtë njoftohet edhe Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës.*

4. Të ndryshme

a) Formimi i komisionit vlerësues për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitet 2008 dhe 2009

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri e nxori këtë

VENDIM

Formohet komisioni vlerësues për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitet 2008 dhe 2009.

Anëtarë të këtij Komisioni janë: Riza Smaka, Gani Koci, Naser Osmani, Enis Kervan dhe Kosara Nikoliq.

Në komisionin vlerësues duhet të asistojë edhe një zyrtar nga Zyra e Rregullatorit të Prokurimit Publik.

b) Mbledhja e radhës e Komisionit

Në mbledhjen e radhës do të propozohet ky rend dite:

- Shqyrtimi i pasqyrave të audituara të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2009.
- Shqyrtimi i pasqyrave financiare dhe i raportit të Auditorit të Pavarur – Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

E përqatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Haki Shatri